



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK DURRES**

Nr. 819 prot.

Data 15 . 04 .2026

**Lënda:** Njoftim për vend të lire pune

**AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”; të udhëzimit nr.759 , datë 30.09. 2024 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë , menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjes së njësive së zhvillimit të ofruesve të institucioneve ,ofruesve te arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit” i ndryshuar

**QFPP Durres ju njofton krijimin e vendeve të lira për pozicionet :**

1. Instruktor I praktikes profesionale per kursin “ Sipermarres dhe menaxhim i biznesit te vogel” prane QFPP Durres ( 1 person)
2. Instruktor I praktikes profesionale per kursin “ Punime ndertimi ” prane QFPP Durres , Filiali Kruje ( 1 person)
3. Instruktor I praktikes profesionale per kursin “ Aftesi per punesim ” prane QFPP Durres , ( 1 person)

## **1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme**

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar,
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën:
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formë së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

**Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:**

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

## **1. Dokumentet e aplikimit**

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicioni;
- b) jetëshkrimin (CV-në);
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e QFPP Durres brenda dates **29.04.2026**.

3.Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 759, date 30.09.2024  
“Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë , menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të institucioneve , ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit” i ndryshuar

**DREJTORI**  
**AGIM KARAJ**

